



Data: 29/07/2019

Ref.: 1379/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Nuk akreditohet programi i studimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
 - Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci, MA 120 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti Filozofik ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin Filozofik më datë 28.05.2019 me qëllim të vlerësimit të programit të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Stephen Adam dhe znj. Keti Tsotniashvili.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit Filozofik dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet

përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci, MA, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Sipas tyre, Misioni i fakultetit i paraqitur në Strategjinë e zhvillimit të Fakultetit Filozofik 2018-2023 është shumë i gjerë dhe do të duhej të ishte më specifik për të krijuar lidhje më të mirë midis misionit të universitetit, fakultetit dhe rezultateve mësimore. RVV ofron një përshkrim shumë të përgjithësuar të qëllimeve të programit. Gjatë vizitës ekipi i ekspertëve ka gjetur se stafi i fakultetit ka marrë pak informata kthyesë në mënyrë joformale nga disa palë të interesit përkitazi me nevojën për programin në fjalë, mirëpo studentët, të diplomuarit dhe punëdhënësit nuk dinin më shumë se titullin e këtij programi. Prandaj ekspertët kanë ardhur në përfundim se nuk janë shfrytëzuar këshilla akademike dhe profesionale për përcaktimin e rezultateve mësimore të programit.

Po ashtu ekspertët kanë konstatuar se programi nuk i ka të identifikuar prioritetet dhe konceptet kërkimore. Një pjesë e materialeve shtesë të kërkuara nga ekipi i ekspertëve janë vënë në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe, gjë që e ka bërë të pamundur për ekspertët të gjykojnë përshtatshmërinë e tyre. Ekipi i ekspertëve ka konstatuar se programi përmban një numër shumë të madh të moduleve krahasuar me programe të ngjashme aktuale në nivel Evropian. Rregullorja mbi procedurat e sigurimit të cilësisë nuk është vënë në dispozicion në gjuhën angleze, prandaj ekspertët ndërkombëtarë ishin të detyruar të mbështesin vlerësimin e tyre në informatat e dhëna në raportin e vetvlerësimit, në dokumentet tjera të siguruar në gjuhën angleze dhe në informatat e mbledhura gjatë vizitës. Koordinimi dhe ndarja e përgjegjësisë lidhur me menaxhimin e cilësisë në nivel qendror dhe në nivel të fakultetit sipas ekspertëve është mjaftë e paqartë.

Ekipi i ekspertëve ka gjetur se instrumenti i vetëm që aplikohet për sigurimin e cilësisë është pyetësori i studentëve i cili përfshin pyetje lidhur me mësimdhënien. Megjithatë ekspertët kanë vërejtur se shkalla e përgjigjeve të studentëve në këtë pyetësor është mjaft e ulët, dhe kjo është për dy arsye: 1. Pyetësorët nuk janë anonim dhe studentët hezitojnë të përgjigjen, dhe 2. Ankesat e studentëve të paraqitura përmes këtij pyetësori nuk merren parasysh nga institucioni. Po ashtu ekspertët kanë konstatuar se pyetësori nuk mundëson mbledhjen e informatave të duhura prandaj duhet të rishikohet.

Udhëzuesi për vlerësimin e orëve mësimore si i tillë përmban disa pyetje dhe pikëpyetje në tekst, dhe ekipi i ekspertëve dyshon se ky është version punues i dokumentit e jo një dokument i miratuar formalisht. Rezultatet mësimore të programit sipas ekspertëve janë shumë të përgjithshme dhe duhet të rishikohen. Megjithëse programi mban titullin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci MA, vetëm dy prej moduleve përmendin 'diplomacinë' në emrin e tyre, dhe vetëm njëra prej tyre është e fokusuar në aspektin praktik. Ekspertët gjykojnë se një program që mëton të ketë diplomacinë si element kryesorë, ai duhet t përmbajë disa module praktike të cilat përfshijnë shkathtësitë e negocimit, hartimin e dokumenteve informuese ministrore, përgatitjen e komunikatave për media, zhvillimin e rekomandimeve alternative për politika etj. gjë që programi në fjalë nuk i ka. Sa i përket metodave të vlerësimit ekspertët kanë konstatuar se modulet nuk japin detaje apo shpjegime, përveç informatave të thjeshta si: test,

provim, test me shkrim e seminar, dhe kjo mungesë e informacionit ka bërë të pamundur për ekspertët që të gjykojnë nëse niveli dhe natyra e vlerësimit është e përshtatshme për studime të nivelit master. Është e paqartë se si shkathtësitë dhe kompetencat esenciale vlerësohen me metodat e vlerësimit të përshkruar në program. Pjesa më e madhe e moduleve kanë qasjen e njëjtë të vlerësimit të studentëve e cila përfshinë 'vijueshmërinë' dhe 'pjesëmarrjen aktive' ku të dyja bashkë përbëjnë 20-25% të vlerësimit. Për ekipin e ekspertëve nuk është e qartë pse vijueshmëria duhet të merret parasysh për fitimin e kredive ECTS, dhe cilat janë kriteret që matin pjesëmarrjen aktive.



Sa i përket moduleve të propozuara për këtë program, ekipi i ekspertëve ka identifikuar një numër çështjesh që duhet të adresohen, duke përfshirë: Nuk është e qartë pse 'Politika e jashtme e Kosovës' është lëndë zgjedhore kur dihet natyra dhe titulli i programit; shumica e moduleve nuk rekomandojnë artikuj të revistave që janë esenciale për studime të nivelit master; modulet *Law and International Organisations, Balkan Geopolitics, International Conflict Resolution, dhe Common Foreign and Security Policy* në raportin e vetvlerësimit faqe 71-82 janë përshkruar si lëndë zgjedhore, kurse në vende tjera janë përmendur si të obligueshme (RVV faqe 11 dhe 38).

Rrjedhimisht, ekspertët kanë konkluduar se programi i studimit nuk përmbush standardet e akreditimit dhe kanë dhënë rekomandim për mos akreditimin e këtij programi të studimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit Filozofik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë